



A.nr.2090/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, dhe Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Argjenda Sherifi, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.2090/2026, të datës 30.12.2025, të parashtruar nga ankuesja M.Zh, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.06.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.2090/2025, e datës 30.12.2025, e parashtruar nga ankuesja M.Zh.

II. Detyrohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës që në pajtim me pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi të anuloj Aktin e emërimit të ankuses Nr. 01-112-1313, të datës 16.11.2024.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, duhet të njoftohet lidhur me veprimet e ndërmarra në zbatim të këtij vendimi ashtu siç përcaktohet në pikën II të dispozitivit.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, M.Zh. (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 30.12.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me bazë pretendimi për mos realizmin të koeficienti të pagës sipas Aktit të emërimit Nr.01-112-1313, të datës 16.11.2024.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Kolegji i Këshillit) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa, kjo e fundit, nuk ka dhënë përgjigje në pretendimet ankimore, por ka përcjell shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokoli 8126/2025, të datës 30.12.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën me numër protokoli 8126/2025, të datës 30.12.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 04.08.2025 drejtuar Sektorit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës; Kopjen e letërnjoftimit; Akt emërimit e datës 16.11.2024 me numër 01-112-1313; Përgjigje në ankese e datës 23.01.2026; Akt emërimit e ankueses e datës 31.12.2024 me numër 01-112-1313; Pershkrimin e detyrave të punës së ankuesës; Vendim e datës 10.07.2023 për përvojën e punës; Kartelën financiare e datës 01.01.2024 deri me datën 31.07.2025.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara, *sepse*:

Gjendja e çështjes

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton:

- Ankuesja është e punësuar në Komunën e Prishtinës dhe së e njëjta sipas Akt Emërimit 01 nr.112-1313 të datës 16.11.2024, ushtron pozitën *Zyrtare për Gjendje Civile*, në kuadër të Drejtorisë së Administratës, ndërsa, organi i punësimit mbi bazën e nenit 102, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë, më datë 31.12.2024 ka lëshuar për ankuesin Aktin e ri të Emërimit me Nr.01-112-1313, për pozitën e njëjtë *Zyrtare për Gjendje Civile*”, më klasë Profesional 2, klasë të pagës GJ33 dhe koeficient të pagës 5.1.
- Ankuesja më datë 04.08.2025 i është drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, me kërkesë për kompensim material sipas koeficientit të pagës 5.1-GJ33, duke iu referuar Aktit të Emërimit të lëshuar më datë 16.11.2024.
- Duke qenë se ankuesja nuk kishte pranuar përgjigje lidhur me kërkesën e datës 04.08.2025, më datë 30.12.2025 ka parashtruar ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të heshtjes administrative, dhe mos realizim të pagës sipas akt emërimit, me pretendimin ankimor se e njëjta është duke u dëmtuar financiarisht, pasi që, pavarësisht faktit se organi i punësimit ia ka lëshuar Aktin e Emërimit me koeficient të pagës (5.1), e njëjta nuk është duke u kompensuar sipas koeficientit të ri.

Pretendimet ankimore

Ankuesja kërkon që të aprovohet ankesa dhe të detyrohet organi i punësimit të zbatoj dhe ekzekutoj Aktin e emërimit me Nr.01-112-1313 të datës 16.11.2024 dhe ti kompensojë pagën sipas koeficientit të pagës 5.1.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, ka shqyrtuar fillimisht kompetencën dhe autorizimin e organit që ka nxjerr aktin mbi bazën e të cilit ankuesja pretendon së buron e drejta e saj materiale si në ankese, dhe si rrjedhojë është konstatuar së Akti i emërimit Nr. 01-112-1313 i datës 16.11.2024, është nxjerrë dhe nënshkruar nga zyrtari publik F.A. në cilësi të ushtruesit të detyrës së Menaxherit të Personelit në Komunën e Prishtinës. Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës del se zyrtari publik F.A. ka ushtruar këtë detyrë sipas Vendimit 14-112/02-0201950/23 të datës 04.10.2023, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për periudhën nga data 12.10.2023 deri më 11.04.2024, Vendimit 14-112/02-43522/24, të datës 39.03.2024,

të Kryetarit të Komunës së Prishtinës për periudhën nga data 12.04.2024 deri më 11.10.2024, dhe sipas Vendimi 14-112/02-0133832/24 të datës 11.10.2024, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për periudhën nga data 12.10.2024 deri më 11.04.2025.

Mbi këto rrethana dhe meqenëse akti i emërimit mbi të cilin ankuesja mbështet pretendimet për kompensim është nxjerr nga ushtruesi i detyrës së Menaxherit të Personelit të Komunës së Prishtinës, Kolegji duke u bazuar në nenin 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik (tutje LZP) më të cilin është përcaktuar se: *1. Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë. 2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit. 3. Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. 4. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni. 5. Çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, është i paligjshëm, konstaton se Komuna e Prishtinës me hyrjen në fuqi të këtij ligji ka qenë e obliguar që caktimin e ushtruesve të detyrës për pozitë drejtuese përkatëse ta bëjë në pajtim me kërkesat ligjore sipas nenit 35 të LZP-së. Andaj, në këtë kontest dhe duke qenë se caktimi i ushtruesit të detyrës së Menaxherit të Personelit të Komunës së Prishtinës, ishte bërë fillimisht më datë 12.10.2023, atëherë, në kuptim të dispozitave të nenit 35 paragrafi 3 të LZP-së caktimi i ushtruesit të detyrës së Menaxherit të Personelit të Komunës së Prishtinës nuk ka mundur të jetë për një periudhë më të gjatë se një (1) vit (6 muaj plus 6 muaj), pra, mbi këtë bazë, zyrtari F.A. ka mundur të ushtroj pozitën e ushtruesit të detyrës së Menaxherit të Personelit të Komunës së Prishtinës vetëm në kohëzgjatje prej një (1) viti, gjegjësisht, vetëm për periudhën kohore 12.10.2023 deri më 11.10.2024 dhe së çdo veprim administrativ pas kësaj periudhë kohore konsiderohet veprim administrativ i ndërmarr nga organi më mungesë të kompetencës ligjore dhe si tillë në kuptim të nenit 52, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA) është akt i paligjshëm.*

Lidhur me konstatimet si më lartë, Kolegji mori parasysh qëndrimin e Gjykatës Supreme sipas Aktgjykimit P.A.nr.07/2025, të datës 10.06.2025, rrjedhimisht, në arsyetimin e këtij aktgjykimi Gjykata Supreme ka konstatuar se: *...Nga kjo dispozitë rrjedh qartë se çdo akt juridik i nxjerrë nga një udhëheqës në cilësinë e ushtruesit të detyrës pas skadimit të afatit prej një viti është i pavlefshëm në thelb, për shkak të mungesës së kompetencës ligjore për të ushtruar funksionet që burojnë nga ajo pozitë..... Ligji i referohet pozitës si funksion institucional dhe jo individit si person. Pra, ndërrimi i personit nuk e ndërpret dhe nuk e rifillon afatin gjashtë muaj, përkatësisht njëvjeçar të ushtrimit të përkohshëm të pozitës. Kjo qasje është në përputhje me frymën e ligjit që kërkon stabilitet, profesionalizëm dhe përgjegjësi institucionale në udhëheqjen publike.*

Nisur nga gjendja e fakteve si më lartë, Kolegji vlerëson se nuk janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuses, pasi që, siç u tha më lartë Akt Emërimi me Nr. 01-112-1313 i datës 16.11.2024, është nënshkruar nga personi më mungesë të kompetencës ligjore, dhe si tillë cilësohet akt i paligjshëm mbi bazën e nenit 52, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të LPPA-së, kështu që, duke qenë se i njëjti nuk kontestohet me ankesë, Kolegji vendosi si në dispozitiv të vendimit, duke refuzuar ankesën si të pabazuar dhe detyroj Njësinë e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës që në pajtim me pikëpamjet juridike si në arsyetimin dhe autorizimet ligjor sipas nenit 53, paragrafi 1 të LPPA-së të anuloj Aktin e emërimit Nr. 01-112-1313, të datës 16.11.2024.

Këshillë juridike: Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.2090/2025

Argjenda SHERIFI

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses, M.Zh;
- Komunës së Prishtinës: Kryetarit të Komunës dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.